

Përrurohet në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Klinika e Ligjit në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri

Në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” u përrurua Klinika e Ligjit, një projekt bashkëpunimi dyvjeçar me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, që do të ofrojë ndihmë juridike falas për qytetarët në nevojë. Studentët dhe profesorët e drejtësisë do të përfshihen në këtë shërbim, duke kombinuar teorinë me praktikën, ndërsa pajisjet dhe literatura e dhuruar nga OSBE-ja do të mbështesin kapacitetet e tyre.

Rektori Prof. dr. Elvira Fetahu theksoi rëndësinë e Klinikës së Ligjit si një hap drejt arsimit praktik dhe angazhimit qytetar, ndërsa Ambasadori Michel Tarran nënvizoi rolin e Klinikës së Ligjit për drejtësinë dhe përkushtimin ndaj çështjeve sociale. Ky partneritet i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” me OSBE-në forcon transparencën dhe llogaridhënien institucionale në funksion të parimit të Shtetit të së Drejtës dhe në përrputhje me vlerat dhe prioritetet e OSBE-së.



